




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 20/DPK	Nr. Prot. Br. Prot. 01-2828/14
Nr. I faq. Broj stranica 02	Data Datum 11-08-2014
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 01.08.2014, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-3534/13, për z. Lirim Mehmeti – Auditor i Brendshëm – Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-3534/13, për z. Lirim Mehmeti – Auditor i Brendshëm në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.**

Në këtë rast zyrtari i lartë z. Mehmeti, është hetuar për situatë të konfliktit të mundshëm të interesit në ushtrimin e funksionit publik si Auditor i Brendshëm në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat “Evropa 92” D.o.o.

Ai fillimisht është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin të procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit. Më pas, z. Mehmeti është takuar me zyrtarët e Agjencisë për t’i sqaruar situatën në të cilën ndodhet dhe për t’i dhënë rekomandimet për ndryshimet që duhet t’i bëj për të shmangur situatën e konfliktit të interesit.

z. Mehmeti, ka pranuar rekomandimin e Agjencisë që të shmanget nga ushtrimi i funksionit menaxhues në biznesin e lartpërmendur, dhe ka deklaruar se këtë do ta bëj në kohë sa më të shpejtë.

Mirëpo, ai nuk i ka kryer ndryshimet në afatin e premtuar, prandaj Agjencia i ka dërguar shkresën e dytë (shkresën paralajmëruese) me të cilën i është kërkuar që në afatin ligjor të shmang konfliktin e interesit.

Ndërkohë, i njëjti ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03 - 2715/14) me të cilën vërtetohet se ai ka hequr dorë nga pozita e personit të autorizuar në këtë biznes. Me këtë, zyrtari i lartë z. Lirim Mehmeti, ka shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

**II.** Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

